

	POLITIKA E CILËSISË		PO-01
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 1

POLITIKA E CILËSISË

Ndërmarrja Modium Sh.P.K. është e specializuar për ofrimin e zgjidhjeve arkitektonike për projekte rezidenciale, arsimore, kulturore, industriale, tregtare dhe komerciale. Specifikisht, përmes shërbimeve të ofruara, krijohen koncepte origjinale arkitektonike, të cilat përmes prezantimit profesional grafik, mundesojnë zbatimin dhe monitorimin e projekteve ndërtimore në tregun lokal dhe ndërkombëtarë. Gjatë planifikimit të projekteve, në fazën fillestare, Modium ka parasysh zbatimin e praktikave më të mira të punës dhe kujdeset për përkushtim ndaj cilësisë në të gjitha fazat e realizimit të shërbimit.

Qëllimi ynë është ofrimi i shërbimeve cilësore që i përmbushin plotësisht kërkesat e klientëve tonë, të sigurojm pajtueshmëri ligjore, konformitet me standardin ndërkombëtar ISO 9001:2015, përkushtim ndaj vlerave sociale & kulturore në tregjet ku ne operojmë dhe punë konsistente drejt realizimit të objektivave të cilësisë të aprovuara nga menaxhment i ndërmarrjes tonë.

Nëpërmjet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas standardit ISO 9001:2015, do të arrijmë përmbushjen e pritshmërisë së klientëve, partnerëve, pritjeve të organizatave shtetërore, Bordit të MODIUM, punonjësve dhe shoqërisë.

Për të treguar performancë të duhur dhe realizuar objektivat e aprovuara të cilësisë, menaxhmentit në bashkëpunim me ISO ekipin janë të përkushtuar për detyrat në vijim:

- dokumentoj, realizoj dhe vazhdimisht përmirësoj produktivitetin drejt realizimit të kërkesave të klientëve, partnerëve, të gjithë palëve të interesit dhe kërkesat specifike të projekteve në zbatim;
- organizoj të gjitha aktivitetet në konformitet të plotë me përshkrimet e punë të aprovuara duke marr parasysh detyrat & përgjegjësitë e përcaktuara në manual, politika, procedurat standardet operative, instruksion dhe plane;
- sigurojnë konformitet të plotë me kërkesat e standardit ndërkombëtar Standardi ISO 9001:2015;
- përkushtim konsistent drejt përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të proceseve menaxheriale;
- planifikoj dhe zhvilloj vazhdimisht kompetencat e personelit të ndërmarrjes;
- vazhdimisht përditësoj planin e veprimve parandaluese me qëllim të eliminimit të mundësive të shfaqjes së jokonformiteteve;
- zbatoj efektivisht, monitoroj, rishikoj dhe përmirësoj politikën e cilësisë;
- angazhim konsistent dhe sigurim të përkushtimit të gjitha pozitave menaxheriale drejt përmirësimit të vazhdueshëm të SMC;

Përkushtimi i demonstruar në këtë Politikë të Cilësisë realizohet vetëm me menaxhim efektiv të dijes organizative, profesionalizëm, përkushtim në ngritjen e kompetencave, udhëheqje participative, shfrytëzim të teknologjive moderne dhe kërkesave të reja të tregut.

MODIUM Sh.P.K.

22 Dhjetor 2021

Burim Bajraktari, Drejtor ekzekutiv

